



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.463/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Fidane Hasani, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Fidane Hasani nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega Mitrovicë me numër ZL.Anr.463/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i më datën 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Fidane Hasani, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik AKR me të cilën pretendon se se me deklarin e votave të saj në 1101b Zhabar, Shkolla Filllore “Shaban Idrizi”, 1105b, Ura e Gjakut, Shkolla “Skenderbeu” dhe 1112b Kçiq i Madh, Shkolla Bislim Imeri, nuk i kanë figuruar votat të cilët familjarët e ngusht të saj e kanë votuar dhe thekson se në këto vendvotime nuk ka pasur mundësi të ketë komisioner dhe vëzhgues të saj. Kërkon nga Paneli që për këto tre vendvotime të merret parasysh ankesa e saj.

Parashtrësia e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e publikimit të shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të

parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Fidane Hasani, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.463/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.